



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 03.01.2024
Ref. KM-01/24

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10, 11 dhe 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 dt. 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, Shtojca 1 pika 11 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerr:

V E N D I M

Për miratimin e Planit të Përformancës të APK-së për vitin 2024

1. Miratohet Plani i Përformancës të APK-së për vitin 2024.
2. Obligohet Agjencia Pyjore e Kosovës – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Faton Peci
Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Vendimi i dërgohet:

- Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, dhe
- Arkivit.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS/AGENCIJA ZA ŠUME KOSOVA/KOSOVO FOREST AGENCY
Arkivi - Arhiva - Archive
Nr./Br./No.: 8702
Nr./qëndr./ser./No./q: 1+24
Data/Date/Date: 29.12.2023
Prishtinë /a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT


Agjencia Pyjore e Kosovës
Agencija za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	DE-2702/2023				
PËR/ZA/TO:	Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së				
NGA/OD/FROM:	Fidan Dema, Ud. Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës (APK)				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	PLANI I PËRFORMANCËS i APK-së për vitin 2024				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	10	Lokacioni: Kucni: Extension:	Prishtinë	Data: Datum: Date:	29.12.2023

I nderuar Ministër,

Bashkangjitur gjeni për miratim PLANIN E PËRFORMANCËS të APK-së për vitin 2024.

Me respekt!

SHTOJCA: 1 FORMA E PLANIT TË PËRFORMANCËS



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

A. Pjesa përshkruese e Planit të Përformancës së Agjencisë

Përmbledhje Ekzekutive

Grupi Punues për hartimin e Planit të Performancës të Agjencisë Pyjore të Kosovës për vitin 2024, është themeluar me Vendim të Zv. Drejtorit Ekzekutiv të APK-së me datë 13.10.2023, dhe përbëhet nga pesë anëtarë. Në takimet e mbajtura GP pas diskutimeve të shumta, ka përcaktuar objektivat kryesore të punës për vitin 2024, dhe që janë gjithsejtë katër. Objektiva e parë është Projekti i Kadastrit Pyjor të Kosovës. Objektiva e dytë është: Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, tokave pyjore dhe faunës së egër. Objektiva e tretë është Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe nga dëmtues të ndryshëm. Kurse objektiva e katërt është Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore e private dhe nga dhënia në shfrytëzim e tokave pyjore. Projekti i Kadastrit Pyjor të Kosovës, përkatësisht realizimi i tij është një objektiv i rëndësishëm për sektorin e pylltarisë, pasi që përmes tij do të sigurohen të dhënat më kryesore për gjendjen e Fondit Pyjor të vendit, kufijtë e ngastrave, pronësia, kultura etj, si dhe të gjitha informatat tjera relevante për pyjet. Për shkak të kompleksitetit të tij, ky do të jetë projekt tre vjeçar, pasi që në vitin e parë, duhet të përgatitet projekti ideor, dhe pas kësaj të përgatiten termat e referencës dhe të shpallet tenderi për realizimin e tij. Buxheti i planifikuar është 1 500 000. 00 €, prej të cilave në vitin 2024 janë planifikuar 500 000. 00 €, në vitin 2025 janë paraparë 500 000. 00 €, dhe në vitin 2026 po ashtu 500 000. 00 euro.

Objektiva e dytë ka të bëjë me menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore dhe faunës së egër. Në kuadër të këtij objektivi përveç masave dhe aktiviteteve tjera është edhe hartimi i planeve menaxhuese afatgjata pyjore, pyllëzimet dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të pyllëzuara, kryerja e rrallimeve para tregtare dhe furnizimi me ushqim plotësues për faunën e egër. Ky objektiv planifikohet që të realizohet përmes katër aktiviteteve kryesore, kurse buxheti i paraparë është 872 000, 00 €.

Objektivi i tretë është mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe nga dëmtues të ndryshëm, ku janë paraparë pesë aktivitete, kurse gjithsejtë buxheti i planifikuar për këtë objektiv është 1,413,750.00 €.

Objektivi i katërt është Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore e private, dhe nga dhënia në shfrytëzim e tokave pyjore. Në kuadër të kësaj objektive janë tri aktivitete, dhe është bërë planifikimi i të hyrave gjatë vitit 2024 për secilën prej tyre. Kështu planifikohet që nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore dhe private të arkëtohen 1,000 000, 00 €, kurse nga dhënia në shfrytëzim e tokës pyjore

planifikohet që të arkëtohen 1 300 000,00 €. Vlen të përmendet se sa i përket burimeve njerëzore, e veçanërisht kuadrit profesional (inxhinierë të pylltarisë dhe teknik të pylltarisë) gjendja nuk është e mirë, pasi që përveç numrit të vogël të tyre, ata janë edhe duke u larguar nga APK, si dhe duke u pensionuar. Andaj, kjo është një sfidë dhe problem i madh për APK. Po ashtu, edhe kushtet e punës, duke përfshirë sidomos mungesën e zyrave, dhe kushteve tjera teknike, paraqesin një problem në punën e përditshme të personelit të APK. Duke pasur parasysh se kushtet e punës ndikojnë drejtpërsëdrejti në efektivitetin dhe efikasitetin e punës, GP ka përfshirë në planifikimin e PP edhe mjetet financiare për marrjen e objektit me qera për punëtorët e APK-se në Qendër, deri në ndërtimin e objektit të ri të MBPZHR-se. Duhet të kihet parasysh se objekti aktual nuk ka as kushte minimale për punë. Nuk ka salla të takimeve, zyrat janë të vogla, kurse drejtorët e Departamenteve (DFSHP, DMP, DL, DMKE) nuk kanë zyre të veta, punojnë së bashku me punëtorët, duke mos pasur kushte normale të punës, qofte për takime zyrtare, të brendshme apo të jashtme. Gjithashtu, duhet pasur parasysh edhe transferin e kompetencave sipas Ligjit të ri për pyjet, me çka volumi i punëve në APK do të rritet jashtëzakonisht shumë. Gjithsesi, që kjo ndikon në efikasitetin në punë, dhe lidhur me këtë është qëndrim unanimit i GP për nevojën e marrjes së përkohshme të një objekti me qera.

1. Hyrje

Hartimi i Planit të Performancës së APK-së për vitin 2024, bazohet në N. 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Plani i performancës, ka për synim realizimin e obligimeve ligjore, që rrjedhin edhe nga Neni 29 i Ligjit të lartcekur, mbi bazën e të cilit, bëhet mbikëqyrja administrative shtetërore e performancës, dhe veprimtarisë e cila realizohet nga njësia përgjegjëse, sipas këtij Neni e që është MBPZHR në kuadër të së cilës është APK. APK referuar N.30 të Ligjit Nr. 06/L-113, për vitin 2024 brenda afateve të përcaktuara dhe duke respektuar kuadrin ligjor për hartimin e Planit të Performancës, dhe kuadrit logjik, që përcakton objektivat që synohen të arrihen me indikatorë matës, e krahasues të rezultateve, duke pasqyruar edhe produktin e realizuar, i cili pasqyrohet me koston financiare për vitin 2024. APK ka paraparë gjithsejtë 4 objektiva me gjithsejtë 15 aktivitete, të specifikuar me koston financiare dhe afatet e realizimit. Baza Ligjore të cilës i është referuar APK për përgatitjen e planit, përveç Ligjit Nr. 06/L-113, është edhe Ligji Nr. 08/L-137 Për Pyjet e Kosovës, të Ligjit për Gjuetinë Nr. 02/L-53, dhe të akteve nënligjore që burojnë nga këto Ligje, dhe Rregullores QRK-Nr.16/2014 Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizmin e Vendeve të Punës në APK.

Qëllimi i Planit të Performancës së APK-ës për vitin 2024 përmes këtyre 4 objektivave është: Synojmë fillimin e punës në projektin trevjeçar Kadastrë Pyjor i Kosovës për të cilin janë ndare 1.5 milion euro, roli i të cilit përcaktohet edhe në Ligjin për Pyjet Nr.08/L-137. Në nenin 23 të këtij Ligji përkatësisht Kadastra e pyjeve dhe tokës pyjore, është përcaktuar se kadastra pyjore përfshin shënimet bazike dhe të dhënat mbi pyjet dhe tokat pyjore, si dhe vlera e tyre ekonomike. APK në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse mban shënimet mbi të gjitha elementet e kadastrës pyjore, mirëmban dhe i përditëson ato. Në Ligj po ashtu theksohet se baza e të dhënave të kadastrës pyjore është pjesë përbërëse e Sistemit Informatik për Pyjet e Kosovës. Gjithashtu, ceket se përmbajtja dhe struktura e detajuar e bazës së të dhënave të kadastrës për pyje, si dhe metodologjia për vlerësimin e vlerës ekonomike të pyjeve dhe tokës pyjore, përcaktohet me akt nënligjor nga MBPZHR. Duke filluar realizimin e kësaj objektive dhe të këtij projekti trevjeçar, behet një hap i madh në drejtim të

realizimit të objektivës së përgjithshme të sektorit për menaxhim të qëndrueshëm e shumëqëllimor të sektorit të pylltarisë, si dhe rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në sektorin e pylltarisë në Kosovë.

Gjithashtu përfshihen edhe veprimet në sektorin e gjuetisë, e që do të krijojë rritje të hyrave nga këta dy sektorë si rezultat i shfrytëzimeve legale, pyje kualitative, kafshë të shëndetshme, klimë më të përshtatshme, më pak përmytje e erozione, më pak ortekë e më shumë reshje, zvogëlim të prerjeve ilegale dhe gjuetisë ilegale, ajër më të pastër, më shumë punësime, më pak sipërfaqe të zhveshura, pyllëzime dhe mirëmbajtje më kualitative, zvogëlim të migrimit nga vendet rurale, më shumë investime në viset rurale dhe krijim të të ardhurave e rritje të numrit të të punësuarve.

Plani i Përformancës është hartuar duke u bazuar në Rregulloren (QRK) NR. 03/2020 Për Performancën e Agjencive. Në dokument janë paraqitur objektivat që APK synon t'i arrijë brenda periudhës një vjeçare, dhe këto Objektiva janë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të afatizuara dhe secila prej tyre adreson problemin dhe cakun e arritshmërisë. Objektivat janë në pajtim me prioritetet e APK-së, dhe objektivat afatmesme të MBPZHR-së, përkatesisht të Qeverisë, të harmonizuara me PVPQ. Objektivat e paraqitura në këtë plan synojnë zbatimin e mandatit të APK dhe janë të ndërlidhura njëra me tjetrën.

Plani i Performances është punuar sipas metodologjisë së paraqitur në rregulloren QRK Nr.03/2020 për performancën e Agjencive, duke plotësuar të gjithë formularët sipas të dhënave të paraqitura dhe duke bërë mbledhjen e të dhënave, shqyrtimin e opsioneve dhe konsultimin me palët e ndërlidhura. Agjencia Pyjore e Kosovës ka kontroll të brendshëm, dhe çdo vit, bënë matjen e rrezikut mbi zbatimin e objektivave të paraqitura në planin vjetor të punës. Rreziqet dhe sfidat të cilat mund të paraqiten gjatë zbatimit të këtij plani janë disa, dhe përveç stafit të pamjaftueshëm profesional inxhiniero-teknik, kushteve të papërshtatshme të punës, përfshijnë edhe:

Mos ndarja eventuale e buxhetit i cili është planifikuar për zbatimin e planit, si dhe burimet tjera buxhetore apo të donatorëve, përkatesisht projektet me financim jashtë buxhetit.

Vonesat gjatë procedurave të prokurimit.

Hapat që do të ndërmerren në evitimin e këtyre rreziqeve përfshijnë: Planifikimi me kohë, menaxhimi adekuat, dhe vetëdijesimi i të gjitha niveleve të menaxhimit në APK për rrezikun dhe shkallën e tij përgjatë aktivitetit për zbatimin e objektivave nga Plani i Përformancës në APK.

Menaxhimi efektiv i rrezikut shton vlerën e të gjitha aktiviteteve duke rritur mundësinë e suksesit dhe zvogëlimin e mundësive të dështimeve në segmente të caktuara të punës.

3. Përmbledhje e Objektivave

Objektiva 1. Përmes realizimit të kësaj objektivë APK planifikon fillimin e punës në realizimin e projektit trevjeçar Kadastrit Pyjor i Kosovës, për të cilin projekt janë ndare gjithsejtë 1.5 milion euro. Roli dhe rëndësia e Kadastrit të pyjeve dhe tokave pyjore për APK është shumë e madhe, dhe kjo është një nevojë e kahershme në kryerjen e punëve dhe aktiviteteve të rregullta të APK-së. Realizimi i kësaj objektivë do të lehtësojë shumë punën e stafit të APK-së dhe njëkohësisht do të rritë efektivitetin në punë, por do të ketë ndikim të madh edhe në menaxhimin me efikasitet të resurseve të pyjeve dhe tokave pyjore të vendit tone. Në fakt, bazuar edhe në kërkesat në rritje të vazhdueshme, si dhe të një dinamike të lartë të

punës, përmes kadastrës pyjore stafi i APK-se do të ketë në dispozicion një mjet të rëndësishëm pune për realizimin e punëve të përditshme dhe të mandatit ligjor. Kadastra pyjore përfshin shënimet bazike dhe të dhënat mbi pyjet dhe tokat pyjore, si dhe vlerën e tyre ekonomike. APK në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse do të mban shënimet mbi të gjitha elementet e kadastrës pyjore, do t'i mirëmban dhe i përditëson ato. Baza e të dhënave të kadastrës pyjore është pjesë përbërëse e Sistemit Informatik për Pyjet e Kosovës. Përmbajtja dhe struktura e detajuar e bazës së të dhënave të kadastrës për pyje, si dhe metodologjia për vlerësimin e vlerës ekonomike të pyjeve dhe tokës pyjore, do të përcaktohet me akt nënligjor nga MBPZHR. Jemi të bindur, se duke filluar realizimin e kësaj objektive dhe të këtij projekti trevjeçar, behet një hap i madh në drejtim të realizimit të objektives së përgjithshme të sektorit për menaxhim të qëndrueshëm e shumëqëllimor të sektorit të pylltarisë, si dhe rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në sektorin e pylltarisë në Kosovë.

Për të realizuar këtë projekt, janë planifikuar mjete financiare në shume të përgjithshme prej 1.5 milion euro. Projekti do të realizohet brenda periudhës trevjeçare (2024, 2025 dhe 2026). Në vitin 2024 do të realizohen tri aktivitete. 1. Hartimi i Udhëzimit Administrativ për kadastrin pyjor; 2. Hartimi i projektit ideor të Kadastrit Pyjor; 3. Hartimi i Termave të Referencës dhe metodologjisë për shpalljen e tenderit; dhe 4. Fillimi i implementimit të Kontratës për Kadastrin Pyjor. Vlera financiare e projektit për vitin 2024 është gjithsejtë 500.000,00 €.

Objektivi 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, tokave pyjore dhe faunës së egër- Ligji për Pyjet NR.08/L-137, përkatësisht në nenin 10 – Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve thotë: “Menaxhimi i pyjeve ushtrohet në mënyrë të qëndrueshme, në përputhje me kriteret ndërkombëtare për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe me udhëzimet operacionale kombëtare, bazuar në këto kritere. Treguesit e kriterëve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës do të identifikohen në nivel kombëtar përmes metodologjisë unike. Të dhënat për treguesit mbledhen, vlerësohen dhe raportohen periodikisht nga APK”.

Në këtë drejtim, Kosova do të menaxhojë pyjet e saj në pajtim me deklaratën e parimeve për konsensusin global mbi menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha tipeve të pyjeve të dhëna në aneksin III të raportit të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (Rio de Zhaneiro, 3-14.06.1992), duke përfshirë parimet:

(a) Parimi parandalues; (b) Konservimi i diversitetit biologjik; (c) Parimi i barazisë ndërbreznore, dhe (d) Zhvillimi ekologjik i qëndrueshëm.

Prandaj, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, nënkupton ndër të tjera edhe zbatimin e kriterëve të mëposhtme: Mirëmbajtja dhe zgjerimi i duhur i ekosistemit pyjor dhe kontributi i tyre në ciklin global të karbonit; Mirëmbajtja e shëndetit pyjor dhe vitalitetit të ekosistemit pyjor; Mirëmbajtja dhe nxitja e funksioneve prodhuese të pyjeve; Mirëmbajtja, ruajtja dhe zgjerimi i biodiversitetit në ekosistemin pyjor; Mirëmbajtja dhe zgjerimi i funksionit mbrojtës në menaxhimin e tokës pyjore, dhe Mirëmbajtja e funksioneve dhe kushteve tjera socio-ekonomike.

Bazuar në mundësitë buxhetore dhe kapacitetet profesionale, APK për të realizuar këtë objektivë planifikon aktivitetet në vazhdim:

- Hartimi i Planeve Menaxhuese Afatëgjata Pyjore, duke përfshirë edhe pyjet në Parqet Kombëtare, dhe Planet Menaxhuese për kafshe të egra (10 vjeçare)- në vlera financiare prej 250.000,00 € me çka krijohet baza ligjore, dhe orientuese për zhvillim dhe planifikim afatgjatë, të të gjitha punimeve në teren për një Njësi Menaxhuese Pyjore.

- Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të pyllëzuara- vlera financiare e projektit është 320.000,00 €, përmes të të cilit arrihet rritja e sipërfaqes pyjore në Kosovë;
- Rrallime para tregtare ne pyje te reja - vlera e planifikuar e projektit është: 250.000,00 €, dhe përmes këtij aktiviteti bëhet: Trajtimi i pyjeve të reja, nxitja e zhvillimit të tyre, përfitimi i masës drusore dhe biomasës, zvogëlimi i presionit në pyje, si dhe punësimi i popullatës lokale;
- Furnizimi me ushqim plotësues për kafshë të egra në dy Vend Gjuetitë me rëndësi të veçantë (Blinajë dhe Duboçak), ku vlera e planifikuar e projektit është ne shumen prej 52.000,00 €. Gjatë sezonës dimërore parqitet mungesë e ushqimit të mjaftueshëm për kafshë të egra, në këto dy vendgjueti, dhe kësaj APK planifikon mjete financiare për furnizim me ushqim plotësues.

Shuma financiare per realizimin e kësaj objektive per vitin 2024 është planifikuar ne vlerën prej 872.000, 00 Euro.

Objektivi 3: Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe dëmtues të ndryshëm- Përmes realizimit të kësaj objektive parashihet që APK të përmbushë mandatin e saj ligjor në mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale dhe dëmtuesit e ndryshëm. Prerjet ilegale janë një nga problemet më të mëdha në sektorin e pylltarisë dhe rrjedhimisht edhe për APK-ne, dhe kjo veçanërisht pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për pyjet, me të cilin kompetencat për ruajtjen e pyjeve dhe mbrojtjen janë transferuar nga komunat në nivelin qendror, përkatësisht në APK. Siç dihet, pyjet po ashtu janë të ekspozuara edhe ndaj rreziqeve të ndryshme, që shkaktojnë e dëme të konsiderueshme, si p.sh. bakterie, virus, kërpudha, insekte, zjarri, bora, erërat etj të cilat paraqesin apo shkaktojnë humbje ekonomike si dhe zvogëlim të potenciali ekonomik, ekologjik apo mbrojtës të pyjeve. Aktivitetet që do të ndërmerren për realizimin e kësaj objektive janë: 1. Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale, me një buxhet të planifikuar prej 1.203.750.00 euro; 2.Zbatimi i metodave mekanike dhe kimike për mbrojtje dhe parandalim të dëmtuesve dhe sëmundjeve të ndryshme në pyje, me një buxhet të planifikuar prej 50.000, 00 euro (Për vitin 2023 APK ka planifikuar 50.000,00 € me qëllim të parandalimit si dhe intervenimit direkt në mbrojtjen pyjeve nga këta faktorë. Ky aktivitet, i cili do të realizohet nga ndonjë kompani profesionale, i mbikëqyrur dhe monitoruar nga APK); 3.Renovimi i objekteve – zyrave të APK-se (DKR dhe Blinaje), me buxhet të planifikuar prej 100.000,00 euro; 4.Marrja e zyrave me qera për nevojat e stafit të APK-se, me buxhet të planifikuar prej 20.000, 00 euro, dhe 5. Furnizimi me kepuce terreni për stafin e APK-se, me buxhet të planifikuar prej 40.000, 00 euro. Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për realizimin e kësaj objektive do të jete në vlerë prej 1.413.750,00 euro.

Objektivi 4: Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore e private dhe nga dhënia në shfrytëzim të tokave pyjore. Janë të planifikuara aktivitetet në vazhdim:

4.1 Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në Pyjet shtetërore e Private- Bazuar në Ligjin për Pyjet, APK menaxhon dhe administron me pyje shtetërore, ndërsa në pyjet private kryen shërbime tekniko - profesionale .

Te pyjet shtetërore realizimi i të hyrave bëhet përmes shitjes së masës drusore me tender (rreth 43.000 m³) dhe shitja e masës drusore me pakicë (rreth 17.800 m³), ndërsa te pyjet private bazuar në trendet e tri viteve paraprake parashihet të krijohen të hyra nga shërbimet në sasi prej rreth 173.500 m³, apo gjithsej të plani për të hyra është rreth 1.000.000.00 €.

4.2 Dhënia në shfrytëzim të tokës pyjore- APK nga dhënia e tokave pyjore me qera planifikon të hyra në vlerë prej rreth 1,300.000.00 €, të cilat do të mblidhen prej kompanive apo personave fizik që shfrytëzojnë tokat pyjore, me kontrata për qëllime të ndryshme si: Përpunimi dhe nxjerrja e gurit, restorante, bujqësi, pemëtari etj.

4.3 Dhënia e dokumentacionit përcjellës për pagesë – me rastin e hartimit dhe pranimit të Kontratave nga ana e APK te Operatorët Ekonomik dhe personat fizik krijohen shpenzime procedurale në vlerë prej: 20.763,00 €.

4.4 Regjistrimi i të hyrave në baza ditore ne SIMFK dhe përcjellja për të gjitha DKR-te në forme elektronike- përcjellja e inkasimit dhe krijimit të të hyrave nga realizmi i kontratave me palë, në APK krijohen shpenzime administrative në vlerë prej rreth 82.654,00 €.

4.5 Hartimi i Raporteve Mujore dhe Periodike lidhur me ecurinë e të hyrave, të obligimeve të kompanive, dhe përgatitja e dokumentacionit për alokim të të hyrave komunave, sipas ligjit- dhe me qëllim të raportimit efikas, dhe me kohë, nevojitet staf profesional i cili krijon shpenzime administrative në vlerë prej rreth 103.283,00 €.

4. Ndikimi buxhetor

Për zbatimin e Planit të Performances të Agjencisë Pyjore të Kosovës për vitin 2024 janë planifikuar mjete buxhetore nga Buxheti i Kosovës në shumën si me poshtë:

Objektivi 1: Për projektin Kadastrri Pyjor i Kosoves, si projekt trevjeçar janë të parapara mjete buxhetore në shumën prej 500,000.00 €, të cilat mjete do të jenë nga Buxheti i Kosovës, për vitin 2024, kurse ne total për tri vite 1.5 milion euro/

Objektivi 2 : Menaxhimi i Qëndrueshëm i Pyjeve, Tokave Pyjore dhe Faunës së Egër janë të parashikuara mjete ne shumën prej 872,000.00 € te cilat mjete buxhetore janë nga Buxheti i Kosovës dhe do te shfrytëzohen:

Aktiviteti 1: Hartimi i Planeve Menaxhuese në shumën prej 250,000.00 €.

Aktiviteti 2: Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe mirëmbajtja e pyllëzimeve, në shumën prej 320,000.00 €;

Aktiviteti 3: Rrallimet para tregtare ne pyjet e reja ne shumën prej 250.000, 00 euro;

Aktiviteti 4:Furnizimi me ushqim plotësues për kafshë të egra, në dy Vend Gjueti me rëndësi të veçantë (Blinajë dhe Duboçak) në shumën prej 52.000,00 € .

Objektivi 3: Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe dëmtues të ndryshëm, janë të parashikuara mjete buxhetore në shumën prej 1.413.750,00 €, dhe do të përdoren:

Aktiviteti 1: Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale, me nje buxhet te planifikuar prej 1.203.750.00 euro;

Aktiviteti 2: Zbatimi i metodave mekanike dhe kimike për mbrojtje dhe parandalim të dëmtuesve dhe sëmundjeve të ndryshme në pyje, me nje buxhet te planifikuar prej 50.000, 00 euro;

Aktiviteti 3: Renovimi i objekteve – zyrave të APK-se (DKR dhe Blinaje), me buxhet te planifikuar prej 100.000,00 euro;

Aktiviteti 4: Marrja e zyrave me qera për nevoja të stafit të APK-se, me buxhet te planifikuar prej 20.000, 00 euro;

Aktiviteti 5: Furnizimi me këpucë terreni për stafin e APK-se, me buxhet te planifikuar prej 40.000, 00 euro.

Pra, Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për realizimin e kësaj objektive do të jetë në vlerë prej 1.413.750,00 euro.

Objektivi 4 : Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore e private dhe nga dhënia në shfrytëzim të tokave pyjore. Janë të planifikuara aktivitetet në vazhdim:

Me realizimin e këtij objektivi, APK do t'i realizoj 2,300,000.00 € të hyra, të cilat do të hyjnë në Buxhetin e Kosovës. Gjithsej plani për të hyra përmes këtij aktiviteti është rreth 1.000.000.00 €.

Aktiviteti 2: Arkëtimi i të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e tokës pyjore, sipas planifikimit nga ky aktivitet do të arkëtohen, dhe do të derdhen në Buxhetin e Kosovës shume prej 1.300.000.00 €.

Pra: Shpenzimet që do të krijohen për realizimin e të hyrave të planifikuara te përmendura ne dy aktivitetet me larte, do te jene ne shumen prej 206.700, 00 euro.

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat					Vlerat bazë (baseline)	Caku
Nr.I.	Objektivi 1: Kadastrin Pyjor Kosovës						
1.	Treguesi i performances:						
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burim financiar	Produkti (output)	
1.1	Hartimi i Udhëzimit Administrativ për Kadastrin Pyjor	APK	Janar 2024	-	BK	Hartimi i UA dhe implementimi i Ligjit të ri për pyjet	
1.2	Hartimi i projektit ideor të Kadastrit Pyjor	APK	Shkurt 2024	10 000,00	BK	Hartimi i Projektit ideor	
1.3	Hartimi i Termave të Referencës dhe metodologjisë për shpalljen e tenderit	APK	Prill 2024	-	BK	Shpallja e tenderit	
1.4	Fillimi i implementimit të Kontratës për Kadastrin Pyjor	APK	36 muaj	500 000,00	BK	Krijimi i Sistemit – Kadastrin Pyjor	
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin I:</i>						
Nr.	Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet					Vlerat bazë (baseline)	Caku
Nr.II.	Objektivi 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, tokave pyjore dhe faunës së egër						

1.	Treguesi i përformancës: Krijimi i mundësive për respektim të parimit të balansit në mes të shtimitit dhe shfrytëzimit vjetor të pyjeve		Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	X [vit]	x
	Nr.	Aktiviteti					
2.1	Hartimi i Planeve Menaxhuese Afatgjata Pyjore, duke përfshirë edhe pyjet ne Parqet Kombëtare, dhe Planet Menaxhuese për kafshe te egra (10 vjeçare)	DKR -të, APK	Prill- Dhjetor	250.000 €	Buxheti i Kosovës	Buxheti i Kosovës	Sigurimi i të dhënave për Njësitë Menaxhuese lidhur me gjendjen aktuale, fondin pyjor, si dhe mënyrat e ndërhyrjes në pyje, përfshirë edhe pyjet ne Parqet Kombëtare si dhe hartimin e dokumentit final përkatës.
2.2	Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe mirëmbajtja sipërfaqeve të pyllëzuara	DKR-të, APK	Janar –Dhjetor	320.000 €	Buxheti i Kosovës	Buxheti i Kosovës	Rritja e Fondit Pyjor
2.3	Rrallimet para tregtare në pyje te reja	DKR-të, APK	Qershor- Dhjetor	250 000,00	Buxheti i Kosovës	Buxheti i Kosovës	Përmirësimi i strukturës se pyjeve
2.4	Furnizimi me ushqim plotësues për kafshë të egra, në dy Vend Gjuetitë me rëndësi të veçantë, (Blinajë dhe Duboçak)	DMKKEGJET	Qershor-Nëntor	52 000, 00	Buxheti i Kosovës	Buxheti i Kosovës	Përkujdesja ndaj kafshëve te egra me qellim te shtimit te fondit të kafshëve të egra.
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:				872 000,00			

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlerat bazë (baseline)	Caku
Objektivi 3: Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe dëmtues të ndryshëm			
Nr.3	(Treguesi i performances): Përmes masave direkte dhe preventive të kemi pyje të pa dëmtuara dhe të shëndosha	X [vit]	
1.			
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit
			Buxheti
3.1	Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale		1,203,750.00
			Janar-Dhjetor
3.2	Zbatimi i metodave mekanike dhe kimike për mbrojtje dhe parandalim të dëmtuesve të ndryshëm në pyje	DKR-të, DMP	Janar-Dhjetor
			50,000.00
3.3	Renovimi i objekteve-zyrave të APK-se (DKR-te dhe Blinaje)		Prill-Dhjetor
			100,000.00
3.4.	Marrja e zyrave me qera për nevoja të stafit të APK-se		Mars-Dhjetor
			20,000.00
3.5	Furnizimi me këpucë terreni për stafin e APK-se		Prill-Dhjetor
			40,000.00
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 3:		1,413,750.00

Nr.	Objektivat, treguesit dhe deftyrat	Vlerat bazë (baseline)	Caku
Objektivi 4: Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore e private, dhe nga dhënia në shfrytëzim e tokave pyjore			
Nr. 4.1	<p>(Treguesi i përformances): Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore ne pyjet shtetërore dhe ne pyjet private</p> <p>(Treguesi i përformancës) Dhënia në shfrytëzim e tokës pyjore</p>	<p>Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore dhe ne pyjet private</p> <p>Janar-Dhjetor</p> <p>1,000,000.00</p>	<p>Plotësimi i kërkesave për dru zjarri dhe dru teknik, si dhe njëkohësisht trajtimi i pyjeve</p>
1.	Arkëtimi i të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e tokës pyjore, si dhe të hyrave të tjera.	Janar-Dhjetor	Përmirësimi meliorativ i tokave, zhvillimi ekonomik dhe pjesëmarrja në zhvillimin e sektorëve tjerë ekonomik
Nr. 4.2	Aktiviteti	Afati i zbatimit	Produkti (output)
4.1	Dhënia e dokumentacionit përcjellës për pagesë	Janar-Dhjetor	Buxheti i Kosovës
4.2	Regjistrimi i të hyrave në baza ditore në SIMFK, dhe përcjellja për të gjitha DKR-të në formë elektronike	Janar-Dhjetor	Buxheti i Kosovës
		20,763.00	Caktimi i shumës së pagesës
		82,654.00	Pasqyra e pagesave të realizuara

4.3	Hartimi i Raporteve Mujore dhe Periodike lidhur me ecurinë e te hyrave, te obligimeve te OE dhe përgatitja e dokumentacionit për alokim te hyrave autoriteteve komunale sipas ligjit ne fuqi .	DFSHP, DKR-të, DMKE dhe DHPPPF	Janar-Dhjetor	103,283.00	BK	Rapotet mujore, periodike për të hyrat e krijuara ,obligimeve të Operatorëve Ekonomik dhe alokimi i shumës së mjete për Autoritetet Komunale
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 4:						
				206,700.00	Shpenzimet që do të krijohen për realizimin e të hyrave të planifikuara	

SHTOJCA: 1 FORMA E PLANIT TË PËRFORMANCËS



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

A. Pjesa përshkruese e Planit të Përformancës së Agjencisë

Përmbledhje Ekzekutive

Grupi Punues për hartimin e Planit të Performancës të Agjencisë Pyjore të Kosovës për vitin 2024, është themeluar me Vendim të Zv. Drejtorit Ekzekutiv të APK-së me datë 13.10.2023, dhe përbëhet nga pesë anëtarë. Në takimet e mbajtura GP pas diskutimeve të shumta, ka përcaktuar objektivat kryesore të punës për vitin 2024, dhe që janë gjithsejtë katër. Objektiva e parë është Projekti i Kadastrit Pyjor të Kosovës. Objektiva e dytë është: Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, tokave pyjore dhe faunës së egër. Objektiva e tretë është Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe nga dëmtues të ndryshëm. Kurse objektiva e katërt është Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore e private dhe nga dhënia në shfrytëzim e tokave pyjore. Projekti i Kadastrit Pyjor të Kosovës, përkatësisht realizimi i tij është një objektiv i rëndësishëm për sektorin e pylltarisë, pasi që përmes tij do të sigurohen të dhënat më kryesore për gjendjen e Fondit Pyjor të vendit, kufijtë e ngastrave, pronësia, kultura etj, si dhe të gjitha informatat tjera relevante për pyjet. Për shkak të kompleksitetit të tij, ky do të jetë projekt tre vjeçar, pasi që në vitin e parë, duhet të përgatitet projekti ideor, dhe pas kësaj të përgatiten termat e referencës dhe të shpallet tenderi për realizimin e tij. Buxheti i planifikuar është 1 500 000. 00 €, prej të cilave në vitin 2024 janë planifikuar 500 000. 00 €, në vitin 2025 janë paraparë 500 000. 00 €, dhe në vitin 2026 po ashtu 500 000. 00 euro.

Objektiva e dytë ka të bëjë me menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore dhe faunës së egër. Në kuadër të këtij objektivi përveç masave dhe aktiviteteve tjera është edhe hartimi i planeve menaxhuese afatgjata pyjore, pyllëzimet dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të pyllëzuara, kryerja e rrallimeve para tregtare dhe furnizimi me ushqim plotësues për faunën e egër. Ky objektiv planifikohet që të realizohet përmes katër aktiviteteve kryesore, kurse buxheti i paraparë është 872 000, 00 €.

Objektivi i tretë është mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe nga dëmtues të ndryshëm, ku janë paraparë pesë aktivitete, kurse gjithsejtë buxheti i planifikuar për këtë objektiv është 1,413,750.00 €.

Objektivi i katërt është Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore e private, dhe nga dhënia në shfrytëzim e tokave pyjore. Në kuadër të kësaj objektive janë tri aktivitete, dhe është bërë planifikimi i të hyrave gjatë vitit 2024 për secilën prej tyre. Kështu planifikohet që nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore dhe private të arkëtohen 1,000 000, 00 €, kurse nga dhënia në shfrytëzim e tokës pyjore

planifikohet që të arkëtohen 1 300 000,00 €. Vlen të përmendet se sa i përket burimeve njerëzore, e veçanërisht kuadrit profesional (inxhinierë të pylltarisë dhe teknik të pylltarisë) gjendja nuk është e mirë, pasi që përveç numrit të vogël të tyre, ata janë edhe duke u larguar nga APK, si dhe duke u pensionuar. Andaj, kjo është një sfidë dhe problem i madh për APK. Po ashtu, edhe kushtet e punës, duke përfshirë sidomos mungesën e zyrave, dhe kushteve tjera teknike, paraqesin një problem në punën e përditshme të personelit të APK. Duke pasur parasysh se kushtet e punës ndikojnë drejtpërsëdrejti në efektivitetin dhe efikasitetin e punës, GP ka përfshirë në planifikimin e PP edhe mjetet financiare për marrjen e objektit me qera për punëtorët e APK-se në Qendër, deri në ndërtimin e objektit të ri të MBPZHR-se. Duhet të kihet parasysh se objekti aktual nuk ka as kushte minimale për punë. Nuk ka salla të takimeve, zyrat janë të vogla, kurse drejtorët e Departamenteve (DFSHP, DMP, DL, DMKE) nuk kanë zyre të veta, punojnë së bashku me punëtorët, duke mos pasur kushte normale të punës, qofte për takime zyrtare, të brendshme apo të jashtme. Gjithashtu, duhet pasur parasysh edhe transferin e kompetencave sipas Ligjit të ri për pyjet, me çka volumi i punëve në APK do të rritet jashtëzakonisht shumë. Gjithsesi, që kjo ndikon në efikasitetin në punë, dhe lidhur me këtë është qëndrim unanim i GP për nevojën e marrjes së përkohshme të një objekti me qera.

1. Hyrje

Hartimi i Planit të Performancës së APK-së për vitin 2024, bazohet në N. 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Plani i performancës, ka për synim realizimin e obligimeve ligjore, që rrjedhin edhe nga Neni 29 i Ligjit të lartcekur, mbi bazën e të cilit, bëhet mbikëqyrja administrative shtetërore e performancës, dhe veprimtarisë e cila realizohet nga njësia përgjegjëse, sipas këtij Neni e që është MBPZHR në kuadër të së cilës është APK. APK referuar N.30 të Ligjit Nr. 06/L-113, për vitin 2024 brenda afateve të përcaktuara dhe duke respektuar kuadrin ligjor për hartimin e Planit të Performancës, dhe kuadrit logjik, që përcakton objektivat që synohen të arrihen me indikatorë matës, e krahasues të rezultateve, duke pasqyruar edhe produktin e realizuar, i cili pasqyrohet me koston financiare për vitin 2024. APK ka paraparë gjithsejtë 4 objektiva me gjithsejtë 15 aktivitete, të specifikuar me koston financiare dhe afatet e realizimit. Baza Ligjore të cilës i është referuar APK për përgatitjen e planit, përveç Ligjit Nr. 06/L-113, është edhe Ligji Nr. 08/L-137 Për Pyjet e Kosovës, të Ligjit për Gjuetinë Nr. 02/L-53, dhe të akteve nënligjore që burojnë nga këto Ligje, dhe Rregullores QRK-Nr.16/2014 Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në APK.

Qëllimi i Planit të Performancës së APK-ës për vitin 2024 përmes këtyre 4 objektivave është: Synojmë fillimin e punës në projektin trevjeçar Kadastrë Pyjor i Kosovës për të cilin janë ndare 1.5 milion euro, roli i të cilit përcaktohet edhe në Ligjin për Pyjet Nr.08/L-137. Në nenin 23 të këtij Ligji përkatësisht Kadastra e pyjeve dhe tokës pyjore, është përcaktuar se kadastra pyjore përfshin shënimet bazike dhe të dhënat mbi pyjet dhe tokat pyjore, si dhe vlera e tyre ekonomike. APK në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse mban shënimet mbi të gjitha elementet e kadastrës pyjore, mirëmban dhe i përditëson ato. Në Ligj po ashtu theksohet se baza e të dhënave të kadastrës pyjore është pjese përbërëse e Sistemit Informatik për Pyjet e Kosovës. Gjithashtu, ceket se përmbajtja dhe struktura e detajuar e bazës së të dhënave të kadastrës për pyje, si dhe metodologjia për vlerësimin e vlerës ekonomike të pyjeve dhe tokës pyjore, përcaktohet me akt nënligjor nga MBPZHR. Duke filluar realizimin e kësaj objektive dhe të këtij projekti trevjeçar, behet një hap i madh në drejtim të

realizimit te objektives se përgjithshme te sektorit për menaxhim të qëndrueshëm e shumëqëllimor të sektorit të pylltarisë, si dhe rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit ne sektorin e pylltarisë ne Kosove.

Gjithashtu përfshihen edhe veprimet në sektorin e gjuetisë, e që do të krijojë rritje të hyrave nga këta dy sektorë si rezultat i shfrytëzimeve legale, pyje kualitative, kafshë të shëndetshme, klimë më të përshtatshme, më pak përmytje e erozione, më pak ortekë e më shumë reshje, zvogëlim të prerjeve ilegale dhe gjuetisë ilegale, ajër me të pastër, më shumë punësime, më pak sipërfaqe të zhveshura, pyllëzime dhe mirëmbajtje më kualitative, zvogëlim të migrimin nga vendet rurale, më shumë investime në viset rurale dhe krijim të të ardhurave e rritje të numrit të të punësuarve.

Plani i Përformancës është hartuar duke u bazuar ne Rregulloren (QRK) NR. 03/2020 Për Performancën e Agjencive. Në dokument janë paraqitur objektivat që APK synon t'i arrijë brenda periudhës një vjeçare, dhe këto Objektiva janë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të afatizuara dhe secila prej tyre adreson problemin dhe cakun e arritshmërisë. Objektivat janë në pajtim me prioritetet e APK-së, dhe objektivat afatmesme të MBPZHR-së, përkatësisht të Qeverisë, të harmonizuara me PVPQ. Objektivat e paraqitura në këtë plan synojnë zbatimin e mandatit të APK dhe janë të ndërlidhura njëra me tjetrën.

Plani i Performances është punuar sipas metodologjisë së paraqitur në rregulloren QRK Nr.03/2020 për përformancën e Agjencive, duke plotësuar të gjithë formularët sipas të dhënave të paraqitura dhe duke bërë mbledhjen e të dhënave, shqyrtimin e opsioneve dhe konsultimin me palët e ndërlidhura. Agjencia Pyjore e Kosoves ka kontroll të brendshëm, dhe çdo vit, bënë matjen e rrezikut mbi zbatimin e objektiveve të paraqitura në planin vjetor të punës. Rreziqet dhe sfidat të cilat mund të paraqiten gjatë zbatimit të këtij planit janë disa, dhe përveç stafit të pamjaftueshëm profesional inxhiniero-teknik, kushteve te papërshtatshme te punës, përfshijnë edhe:

Mos ndarja eventuale e buxhetit i cili është planifikuar për zbatimin e planit, si dhe burimet tjera buxhetore apo të donatorëve, perkatesisht projektet me financim jashtë buxhetit.

Vonesat gjatë procedurave të prokurimit.

Hapat që do të ndërmerren në evitimin e këtyre rreziqeve përfshijnë: Planifikimi me kohë, menaxhimi adekuat, dhe vetëdijesimi i të gjitha niveleve të menaxhimit në APK për rrezikun dhe shkallën e tij përgjatë aktivitetit për zbatimin e objektiveve nga Plani i Përformancës në APK.

Menaxhimi efektiv i rrezikut shton vlerën e të gjitha aktiviteteve duke rritur mundësinë e suksesit dhe zvogëlimin e mundësive te dështimeve ne segmente te caktuara te punes.

3. Përmbledhje e Objektiveve

Objektiva 1. Përmes realizimit te kësaj objektive APK planifikon fillimin e punës ne realizimin e projektit trevjeçar Kadastrit Pyjor i Kosovës, për te cilin projekt janë ndare gjithsejtë 1.5 milion euro. Roli dhe rëndësia e Kadastrit te pyjeve dhe tokave pyjore për APK është shume i madh, dhe kjo është një nevojë e kahershme ne kryerjen e punëve dhe aktiviteteve te rregullta te APK-se. Realizimi i kësaj objektive do te lehtësojë shume punën e stafit et APK-se dhe njëkohësisht do te rrite efektivitetin ne pune, por do te ketë ndikim te madh edhe ne menaxhimin me efikas te resurseve te pyjeve dhe tokave pyjore te vendit tone. Ne fakt, bazuar edhe ne kërkesat ne rritje te vazhdueshme, si dhe te një dinamike te larte te

punës, përmes kadastrës pyjore stafi i APK-se do të ketë ne dispozicion një mjet të rëndësishëm pune për realizimin e punëve të përditshme dhe të mandatit ligjor. Kadastra pyjore përfshin shënimet bazike dhe të dhënat mbi pyjet dhe tokat pyjore, si dhe vlerën e tyre ekonomike. APK në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse do të mban shënimet mbi të gjitha elementet e kadastrës pyjore, do t'i mirëmban dhe i përditëson ato. Baza e të dhënave të kadastrës pyjore është pjesë përbërëse e Sistemit Informatik për Pyjet e Kosovës. Përmbajtja dhe struktura e detajuar e bazës së të dhënave të kadastrës për pyje, si dhe metodologjia për vlerësimin e vlerës ekonomike të pyjeve dhe tokës pyjore, do të përcaktohet me akt nënligjor nga MBPZHR. Jemi të bindur, se duke filluar realizimin e kësaj objektiviteti dhe të këtij projekti trevjeçar, behet një hap i madh në drejtim të realizimit të objektivitetit se përgjithshme të sektorit për menaxhim të qëndrueshëm e shumëqëllimor të sektorit të pylltarisë, si dhe rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në sektorin e pylltarisë në Kosovë.

Për të realizuar këtë projekt, janë planifikuar mjete financiare në shume të përgjithshme prej 1.5 milion euro. Projekti do të realizohet brenda periudhës trevjeçare (2024, 2025 dhe 2026). Në vitin 2024 do të realizohen tri aktivitete. 1. Hartimi i Udhëzimit Administrativ për kadastrin pyjor; 2. Hartimi i projektit ideor të Kadastrit Pyjor; 3. Hartimi i Termave të Referencës dhe metodologjisë për shpalljen e tenderit; dhe 4. Fillimi i implementimit të Kontratës për Kadastrin Pyjor. Vlera financiare e projektit për vitin 2024 është gjithsejtë 500.000,00 €.

Objektivi 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, tokave pyjore dhe faunës së egër- Ligji për Pyjet NR.08/L-137, përkatësisht në nenin 10 – Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve thotë: “Menaxhimi i pyjeve ushtrohet në mënyrë të qëndrueshme, në përputhje me kriteret ndërkombëtare për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe me udhëzimet operacionale kombëtare, bazuar në këto kritere. Treguesit e kriterëve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve të Kosovës do të identifikohen në nivel kombëtar përmes metodologjisë unike. Të dhënat për treguesit mbledhen, vlerësohen dhe raportohen periodikisht nga APK”.

Në këtë drejtim, Kosova do të menaxhojë pyjet e saj në pajtim me deklaratën e parimeve për konsensusin global mbi menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha tipeve të pyjeve të dhëna në aneksin III të raportit të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (Rio de Zhaneiro, 3-14.06.1992), duke përfshirë parimet:

(a) Parimi parandalues; (b) Konservimi i diversitetit biologjik; (c) Parimi i barazisë ndërbreznore, dhe (d) Zhvillimi ekologjik i qëndrueshëm.

Prandaj, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, nënkupton ndër të tjera edhe zbatimin e kriterëve të mëposhtme: Mirëmbajtja dhe zgjerimi i duhur i ekosistemit pyjor dhe kontributi i tyre në ciklin global të karbonit; Mirëmbajtja e shëndetit pyjor dhe vitalitetit të ekosistemit pyjor; Mirëmbajtja dhe nxitja e funksioneve prodhuese të pyjeve; Mirëmbajtja, ruajtja dhe zgjerimi i biodiversitetit në ekosistemin pyjor; Mirëmbajtja dhe zgjerimi i funksionit mbrojtës në menaxhimin e tokës pyjore, dhe Mirëmbajtja e funksioneve dhe kushteve tjera socio-ekonomike.

Bazuar në mundësitë buxhetore dhe kapacitetet profesionale, APK për të realizuar këtë objektivitet planifikon aktivitetet në vazhdim:

- Hartimi i Planeve Menaxhuese Afatëgjata Pyjore, duke përfshirë edhe pyjet në Parqet Kombëtare, dhe Planet Menaxhuese për kafshe të egra (10 vjeçare)- në vlera financiare prej 250.000,00 € me çka krijohet baza ligjore, dhe orientuese për zhvillim dhe planifikim afatgjatë, të të gjitha punimeve në terren për një Njësi Menaxhuese Pyjore.

- Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të pyllëzuara - vlera financiare e projektit është 320.000,00 €, përmes të cilit arrihet rritja e sipërfaqes pyjore në Kosovë;
- Rrallime para tregtare në pyje të reja - vlera e planifikuar e projektit është: 250.000,00 €, dhe përmes këtij aktiviteti bëhet: Trajtimi i pyjeve të reja, nxitja e zhvillimit të tyre, përfitimi i masës drusore dhe biomasës, zvogëlimi i presionit në pyje, si dhe punësimi i popullatës lokale;
- Furnizimi me ushqim plotësues për kafshë të egra në dy Vend Gjuetie me rëndësi të veçantë (Blinajë dhe Duboçak), ku vlera e planifikuar e projektit është ne shumen prej 52.000,00 €. Gjatë sezonës dimërore parqitet mungesë e ushqimit të mjaftueshëm për kafshë të egra, në këto dy vendgjueti, dhe kësaj APK planifikon mjete financiare për furnizim me ushqim plotësues.

Shuma financiare për realizimin e kësaj objektiviteti për vitin 2024 është planifikuar në vlerën prej 872.000,00 Euro.

Objektivi 3: Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe dëmtues të ndryshëm- Përmes realizimit të kësaj objektiviteti parashihet që APK të përmbushë mandatin e saj ligjor në mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale dhe dëmtuesit e ndryshëm. Prerjet ilegale janë një nga problemet më të mëdha në sektorin e pylltarisë dhe rrjedhimisht edhe për APK-në, dhe kjo veçanërisht pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për pyjet, me të cilin kompetencat për ruajtjen e pyjeve dhe mbrojtjen janë transferuar nga komunat në nivelin qendror, përkatësisht në APK. Siç dihet, pyjet po ashtu janë të ekspozuara edhe ndaj rreziqeve të ndryshme, që shkaktojnë e dëme të konsiderueshme, si p.sh. bakterie, virus, kërpudha, insekte, zjarri, bora, erërat etj të cilat paraqesin apo shkaktojnë humbje ekonomike si dhe zvogëlim të potenciali ekonomik, ekologjik apo mbrojtës të pyjeve. Aktivitetet që do të ndërmerren për realizimin e kësaj objektiviteti janë: 1. Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale, me një buxhet të planifikuar prej 1.203.750,00 euro; 2. Zbatimi i metodave mekanike dhe kimike për mbrojtje dhe parandalim të dëmtuesve dhe sëmundjeve të ndryshme në pyje, me një buxhet të planifikuar prej 50.000,00 euro (Për vitin 2023 APK ka planifikuar 50.000,00 € me qëllim të parandalimit si dhe intervenimit direkt në mbrojtjen e pyjeve nga këta faktorë. Ky aktivitet, i cili do të realizohet nga ndonjë kompani profesionale, i mbikëqyrur dhe monitoruar nga APK); 3. Renovimi i objekteve – zyrave të APK-se (DKR dhe Blinaje), me buxhet të planifikuar prej 100.000,00 euro; 4. Marrja e zyrave me qera për nevojat e stafit të APK-se, me buxhet të planifikuar prej 20.000,00 euro, dhe 5. Furnizimi me kepuce terreni për stafin e APK-se, me buxhet të planifikuar prej 40.000,00 euro. Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për realizimin e kësaj objektiviteti do të jetë në vlerë prej 1.413.750,00 euro.

Objektivi 4: Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore e private dhe nga dhënia në shfrytëzim të tokave pyjore. Janë të planifikuara aktivitetet në vazhdim:

4.1 Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në Pyjet shtetërore e Private- Bazuar në Ligjin për Pyjet, APK menaxhon dhe administron me pyje shtetërore, ndërsa në pyjet private kryen shërbime tekniko - profesionale .

Te pyjet shtetërore realizimi i të hyrave bëhet përmes shitjes së masës drusore me tender (rreth 43.000 m³) dhe shitja e masës drusore me pakicë (rreth 17.800 m³), ndërsa te pyjet private bazuar në trendet e tri viteve paraprake parashihet të krijohen të hyra nga shërbimet në sasi prej rreth 173.500 m³, apo gjithsej të plani për të hyra është rreth 1.000.000,00 €.

4.2 Dhënia në shfrytëzim të tokës pyjore- APK nga dhënia e tokave pyjore me qera planifikon të hyra në vlerë prej rreth 1,300.000,00 €, të cilat do të mblidhen prej kompanive apo personave fizik që shfrytëzojnë tokat pyjore, me kontrata për qëllime të ndryshme si: Përpunimi dhe nxjerrja e gurit, restorante, bujqësi, pemëtari etj.

4.3 Dhënia e dokumentacionit përcjellës për pagesë – me rastin e hartimit dhe pranimit të Kontratave nga ana e APK te Operatorët Ekonomik dhe personat fizik krijohen shpenzime procedurale në vlerë prej: 20.763,00 €.

4.4 Regjistrimi i të hyrave në baza ditore ne SIMFK dhe përcjellja për të gjitha DKR-te në forme elektronike- përcjellja e inkasimit dhe krijimit të të hyrave nga realizmi i kontratave me palë, në APK krijohen shpenzime administrative në vlerë prej rreth 82.654,00 €.

4.5 Hartimi i Raporteve Mujore dhe Periodike lidhur me ecurinë e të hyrave, të obligimeve të kompanive, dhe përgatitja e dokumentacionit për alokim të të hyrave komunave, sipas ligjit- dhe me qëllim të raportimit efikas, dhe me kohë, nevojitet staf profesional i cili krijon shpenzime administrative në vlerë prej rreth 103.283,00 €.

4. Ndikimi buxhetor

Për zbatimin e Planit të Performances të Agjencisë Pyjore të Kosovës për vitin 2024 janë planifikuar mjete buxhetore nga Buxheti i Kosovës në shumën si me poshtë:

Objektivi 1: Për projektin Kadastrri Pyjor i Kosoves, si projekt trevjeçar janë të parapara mjete buxhetore në shumën prej 500,000.00 €, të cilat mjete do të jenë nga Buxheti i Kosovës, për vitin 2024, kurse ne total për tri vite 1.5 milion euro/

Objektivi 2 : Menaxhimi i Qëndrueshëm i Pyjeve, Tokave Pyjore dhe Faunës së Egër janë të parashikuara mjete ne shumën prej 872,000.00 € te cilat mjete buxhetore janë nga Buxheti i Kosovës dhe do te shfrytëzohen:

Aktiviteti 1: Hartimi i Planeve Menaxhuese në shumën prej 250,000.00 €.

Aktiviteti 2: Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe mirëmbajtja e pyllëzimeve, në shumën prej 320,000.00 €;

Aktiviteti 3: Rrallimet para tregtare ne pyjet e reja ne shumën prej 250.000, 00 euro;

Aktiviteti 4:Furnizimi me ushqim plotësues për kafshë të egra, në dy Vend Gjueti me rëndësi të veçantë (Blinajë dhe Duboçak) në shumën prej 52.000,00 € .

Objektivi 3: Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe dëmtues të ndryshëm, janë të parashikuara mjete buxhetore në shumën prej 1.413.750,00 €, dhe do të përdoren:

Aktiviteti 1: Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale, me nje buxhet te planifikuar prej 1.203.750.00 euro;

Aktiviteti 2: Zbatimi i metodave mekanike dhe kimike për mbrojtje dhe parandalim te dëmtuesve dhe sëmundjeve te ndryshme ne pyje, me nje buxhet te planifikuar prej 50.000, 00 euro;

Aktiviteti 3: Renovimi i objekteve – zyrave te APK-se (DKR dhe Blinaje), me buxhet te planifikuar prej 100.000,00 euro;

Aktiviteti 4: Marrja e zyrave me qera për nevoja te stafit te APK-se, me buxhet te planifikuar prej 20.000, 00 euro;

Aktiviteti 5: Furnizimi me këpucë terreni për stafin e APK-se, me buxhet te planifikuar prej 40.000, 00 euro.

Pra, Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për realizimin e kësaj objektive do te jete ne vlere prej 1.413.750,00 euro.

Objektivi 4 : Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore e private dhe nga dhënia ne shfrytëzim e tokave pyjore. Janë te planifikuara aktivitetet ne vazhdim:

Me realizimin e këtij objektivi, APK do t'i realizoj 2,300,000.00 € të hyra, të cilat do të hyjnë në Buxhetin e Kosovës. Gjithsej plani për të hyra përmes këtij aktiviteti është rreth 1.000.000.00 €.

Aktiviteti 2: Arkëtimi i të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e tokës pyjore, sipas planifikimit nga ky aktivitet do të arkëtohen, dhe do të derdhen në Buxhetin e Kosovës shume prej 1.300.000.00 €.

Pra: Shpenzimet që do të krijohen për realizimin e të hyrave të planifikuara te përmendura ne dy aktivitetet me larte, do te jene ne shumen prej 206.700, 00 euro.

I.	Treguesi i performancës: Krijimi i mundësive për respektim të parimit të balansit në mes të shtimit dhe shfrytëzimit vijtor të pyjeve						X [vit]	x
	Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi financiar		
2.1	Hartimi i Planeve Menaxhuese Afatgjata Pyjore, duke përfshirë edhe pyjet ne Parqet Kombëtare, dhe Planet Menaxhuese për kafshe te egra (10 vjeçare)	DKR -të, APK	Prill- Dhjetor	250.000 €	Buxheti i Kosovës	Sigurimi i të dhënave për Njësitë Menaxhuese lidhur me gjendjen aktuale, fondin pyjor, si dhe mënyrat e ndërhyrjes në pyje, përfshirë edhe pyjet ne Parqet Kombëtare si dhe hartimin e dokumentit final përkatës.		
2.2	Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe mirëmbajtja sipërfaqeve të pyllëzuara	DKR-të, APK	Janar -Dhjetor	320.000 €	Buxheti i Kosovës	Rritja e Fondit Pyjor		
2.3	Rrallimet para tregtare në pyje te reja	DKR-të, APK	Qershor- Dhjetor	250 000,00	Buxheti i Kosovës	Përmirësimi i strukturës se pyjeve		
2.4	Furnizimi me ushqim plotësues për kafshë të egra, në dy Vend Gjeticitë me rëndësi të veçantë, (Blinajë dhe Duboçak)	DMKKEGJET	Qershor-Nëntor	52 000, 00	Buxheti i Kosovës	Përkujdesja ndaj kafshëve te egra me qellim te shtimit te fondit të kafshëve të egra.		
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:						872 000,00	

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlerat bazë (baseline)	Caku
Objektivi 4: Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore e private, dhe nga dhënia në shfrytëzim e tokave pyjore			
1.	(Treguesi i performances): Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore ne pyjet shtetërore dhe ne pyjet private	Arkëtimi i të hyrave nga shitja e masës drusore në pyjet shtetërore dhe ne pyjet private Janar-Dhjetor 1,000,000.00	Plotësimi i kërkesave për dru zjarri dhe dru teknik, si dhe njëkohësisht trajtimi i pyjeve
2.	(Treguesi i performancës) Dhënia në shfrytëzim e tokës pyjore	Arkëtimi i të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e tokës pyjore, si dhe të hyrave të tjera. Janar-Dhjetor 1,300,000.00	Përmirësimi meliorativ i tokave, zhvillimi ekonomik dhe pjesëmarrja në zhvillimin e sektorëve tjerë ekonomik
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Burimi financiar
4.1	Dhënia e dokumentacionit përcjellës për pagesë	DFSHP, DKR-të DMKKEGJET dhe DHPPPF Janar-Dhjetor 20,763.00	Produkti (output) Caktimi i shumës së pagesës
4.2	Regjistrimi i të hyrave në baza ditore në SIMFK, dhe përcjellja për të gjitha DKR-të në formë elektronike	DFSHP, DKR-të, DMKEKGJET dhe DHPPPF Janar-Dhjetor 82,654.00	Pasqyra e pagesave të realizuara

4.3	Hartimi i Raporteve Mujore dhe Periodike lidhur me ecurinë e te hyrave, te obligimeve te OE dhe përgatitja e dokumentacionit për alokim te hyrave autoriteteve komunale sipas ligjit ne fuqi .	DFSHP, DKR-të, DMKE dhe DHPPPF	Janar-Dhjetor	103,283.00	BK	Raportet mujore, periodike për të hyrat e krijuara ,obligimeve të Operatorëve Ekonomik dhe alokimi i shumës së mjete për Autoritetet Komunale
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 4:</i>			206,700.00		Shpenzimet që do të krijohen për realizimin e të hyrave të planifikuara